

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "EZ Marketing" Sh.p.k.

Sot, më datë 27/06 /2024,

- **Z. Endri Nazaj**, shtetas shqiptar, lindur me 24/08/1988, ne Fier, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer personal I80824052E, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për regjistrimin e biznesit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**EZ Marketing**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**EZ Marketing**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane Tirane Rruga Abdyl Frashëri, Hyrja nr.1, ap nr.1, ZK 8270, Nr pasurie 4/251+1-7, vol.67, faqe 195, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA


Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Studimi, zhvillimi dhe realizimi i faqeve te internetit, faqe te aksesueshme web design si dhe regjistrime, mirembajtje dhe shitje domain internet - housing (administrim, depozitim dhe lidhje) si dhe cdo gje tjetër qe është e nevojshme për asistencë në fushën e informatikës. Realizim dhe zbulim publiciteti në web, në të gjithë menyrat dhe kanalet, si mail, ekran, web radio, web tv, rrjetet sociale dhe të ngjashme. Projektim, realizim dhe dërgim të fushatave promovionale nepermjet postes elektronike, mesazheve, fakseve, telefonatave vokale automatike dhe rrjeteve sociale. Nderim, administrim, optimizim dhe administrim bazash të të dhënave të profilizuara, si dhe arkivave me informacione dhe artikuj për cdo lloj suporti në respektim të normativave që përmban fusha e privatesise. Realizim dhe administrim i 2 njoftimeve "landing page" dhe komunikime shtypi, - ecommerce, - realizim trajnimesh në fushën informatike. Realizim grafike në web, - projektim, realizim dhe administrim konkurses online në respektim me normativat e fushes (lendes). Realizim publikimesh, broshurash, revistash mbi produktet dhe shërbimet e sipërpermdura, përfshirë të drejtën për të operuar edhe në fushën e botimit elektronik dhe



telematik. Asistence per bizneset, individet, organet publike dhe shoqerite ne pergjithesi, per te ndertuar faqet e internetit dhe sistemeve, menaxhimin e programeve, aparateve dhe sherbimeve per 2 telekomunikacionin dhe telematiken, perfshire sherbimet e transmetimit te te dhenave, imazheve dhe tingujve (me figure dhe ze) me reference te vecante per sherbimet e internetit. Ideim, zhvillim, prodhim dhe keshillim ne realizimin e sistemeve baze si dhe cdo gje tjeter qe ka te beje me ruajtjen, trajnimin dhe menaxhimin e te dhenave. Ofrimi i sherbimeve te keshillimit te biznesit ne menaxhim dhe informatike, trajnimit, keshillimit dhe organizimit te ceshtjeve te menaxhimit, kerkime dhe zhvillime te marketingut dhe metodave te futjes ne treg. Krijimin, zhvillimin, prodhimin dhe tregtine edhe ne emer te paleve te treta per software dhe hardware.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 100.000 Lek (*Njeqind mije*) Lek dhe është i përbërë nga një kuotë.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Endri Nazaj**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 Lek (*Njeqind mije*) Lek dhe 100.000 Lek (*Njeqind mije*) Lek të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

Z. Endri Nazaj, shtetas shqiptarë, lindur me 24/08/1988, ne Tirane, mbajtes i dokumentit te identifikimit me numer personal I80824052E, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8



DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 1 (një) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar *Administratorin Z. Endri Nazaj* për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Endri Nazaj 